



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2019:114315

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05829189

Ac.nr.7046/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.B. nga H....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Mimoza Kuka Bushi nga Kaçaniku, kundër të paditurës KEK, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Jetullah Mehmeti, në çështjen kontestuese pagim i dëmit material- rentës mujore, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës, dhe përgjigjejn në ankesë të përfaqësueses së paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik C.nr.82/17 e datës 07.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj– Dega në Kaçanik, C.nr.82/17 i datës 07.07.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.82/17, i datës 07.07.2021, ka vendosur si në vijim:

“ I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.B. nga H.....dhe DEYTROHET e paditura KEK sh.a, me seli në Prishtinë që paditësit ti paguaj rentën siç vijon:

I/a. Për periudhën e kaluar prej datës 08.05.2016 (prej kohës kur ka pushuar të punoj), e deri me datë 31.03.2021, datën kur është bërë ekspertiza, shumë prej 15,303.00 euro. Në këtë shumë edhe kamatën në vlerë prej 2,843.00 euro, duke filluar nga data 24.04.2017 (data e paraqitjes së padisë) deri më datë 31.03.2021, kur është përpiluar ekspertiza nga eksperti aktuar.

I/b. Për periudhën e ardhshme duke filluar nga data 01.04.2021 e tutje, deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, për çdo muaj ti paguaj shumë prej 260.00 euro, respektivisht

430.00 euro nga dita kur ti ndërpritet marrja e pensionit të Veteranit paditësit, kjo pagesë mujore do të paguhet më së voni me datën 5 të muajit të ardhshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit ti paguaj shumën në pikën I/a dhe I/b, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,808.00 euro, të gjitha këto pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.”

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t’ia kthejë të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje, ose ta ndryshoj aktgjykimin duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar e autorizuara e paditësit, dhe atë me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të saj me datë 24.04.2017 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë kundër të paditurës dhe ka kërkuar nga gjykata që kjo padi të miratohet, të detyrohet e paditura që paditësit për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese ti paguaj rentën mujore prej 430.00 euro, duke filluar nga data 08.05.2016 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, e cila pagesë të bëhet më së voni deri me datën 5 të muajit të ardhshëm për secilin këst të arritur për pagesë, të gjitha me kamatë prej 8% duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë gjerë në pagesën përfundimtare, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, me aktgjykimin C.nr.82/17, i datës 07.07.2021, e ka aprovuar tersisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit e duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë pas shikimit dhe analizimit të provave të administruara ka vërtetuar gjendjen faktike si në vijim: paditësi është lënduar në punë me datën 07.07.2012, me fajin e të paditurës, dhe si rezultat i këtij lëndimi paditësit i është zvogëluar aftësia për punë në shkallë prej 100%, e si rezultat i kësaj ka pësuar dëm material në formë të fitimit të humbur. Kërkesa për kompensimin e dëmit ka lindur pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe plotfuqishmërisë së aktgjykimit C.nr.219/12 të datës 10.07.2015. Fakti se paditësi është lënduar në punë, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ku është konstatuar se me datën 07.07.2012, në Lagjen “K.....” gjatë intervenimit për eliminimin e një defekti në rrymë në TS 6/0.4 KV është lënduar paditësi, por ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndergjyqjese. Si rezultat i këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dëm material në formë të fitimit të humbur, sepse për shkak të lëndimeve i njëjti nuk ka mundësi që të punoj, qe nga data 08.05.2016, dhe ju kanë ndërprerë të ardhurat personale. Ndërsa sa i përket dëmit të pësuar kjo është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit aktuar dhe plotësimi i ekspertizës së bërë në seancë dhe me shkrim, ku në mënyrë të detajueshme është sqaruar në paragrafin I në dispozitiv të aktgjykimit. Afati për kërkimin e

fitimit të humbur ka lindur më datën 08.05.2016, kur paditësit ju është ndërprerë pagesa e të ardhurave personale dhe me aktgjykimin C.nr.219/12 i datës 10.07.2015.

Gjykata e shkallës së parë, pas analizimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kërkesëpadinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësit të ia paguaj dëmin material në emër të fitimit të humbur, sepse i njëjti këtë dëm e ka pësuar me fajin e të paditurës. Ky fakt është konstatuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë aktgjykimet C.nr.219/12 i datës 10.07.2015, Ac.nr.3794/15 dhe Ref.nr.408/20 si dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 179.2 të LMD-së, ku me këtë dispozitë është paraparë se në qoftë se i lënduari për shkak të pa aftësisë të plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat i janë shuar vazhdimisht apo mundësitë e zhvillimit të tij të mëtejshëm dhe të përparimit janë zhdukur ose janë pakësuar, person përgjegjës ka për detyrë të ia paguaj të lënduarit, tani paditësit, rentën e caktuar në të holla si kompensim për këtë dëm.

Për sa i përket lartësisë së dëmit, gjykata e shkallës së parë e ka marrë për bazë ekspertizë të aktuarit. Eksperti ka konstatuar se për periudhën e kaluar prej datës 08.05.2016 (prej kohës kur ka pushuar të punojë), e deri më 31.03.2021, datën kur është bërë ekspertiza, paditësit i takon shuma prej 18.146.00 € , shumën prej 15.303 € në emër të rentës për periudhën e kaluar, si dhe shumën prej 2,843.00€ në emër të kamatës, duke filluar nga data e 24.04.2017 (data e paraqitjes së padisë), e deri më datën 31.03.2021, kur është përpiluar ekspertiza nga eksperti aktuar. Tutje eksperti ka konstatuar se për periudhën e ardhshme, duke filluar nga data 01.04.2021 e tutje, derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 260.00 euro, e cila shumë mujore do të paguhet më së voni deri më datën 5 të muajit të ardhshëm. Gjykata e shkallës së parë ka detyruar të paditurën që paditësit të ja paguaj rentën mujore për periudhën e ardhshme në shumë prej 260.00 euro, respektivisht 430.00€ nga dita kur ti ndërpritet marrja e pensionit të Veteranit paditësit. Gjykata e ka caktuar pagesën, në këtë formë duke u bazuar në neni 16 të Ligjit Nr. 04/L-261 për veteranët e Luftës së ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë ka analizuar theksimet e të autorizuarës së paditësit, e cila i propozoi gjykatës që ta miratoj kërkesëpadinë e paditësit, dhe këtyre theksimeve gjykata e shkallës së parë ua ka falur besimin dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit. Se paditësi këtë dëm e ka pësuar pa fajin e tij dhe me fajin e të paditurës, këtë gjykata e ka konstatuar dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lartësinë e kërkesës e ka vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit aktuar. Që një e drejtë e tillë i takon paditësit, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar konform neneve 136 par 1 dhe 177.par 2 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka analizuar theksimet e të autorizuarit të paditurës, i cili ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar dhe paditësi këtë padi ka mundur ta paraqes së bashku me padinë për kompensimin e dëmit, por këto pretendime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse ka vërtetuar faktin se paditësi është lënduar me fajin e të paditurës, Për sa i përket pretendimeve të paditurës se kërkesa është parashkruar sepse rasti ka ndodhur në vitin 2012, ndërsa paditësi padinë e ka paraqitur në vitin 2017, gjykata e shkallës së parë këto theksime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse paditësit të ardhurat personale i janë ndërprerë në vitin 2016, gjegjësisht më datën 08.05.2016, ndërsa padinë për pagimin e rentës paditësi e ka paraqitur më datën 24.04.2017. Paditësit kjo e drejtë i ka lindur që nga vërtetimi i aktgjykimit C.nr.219/12 të datës 10.07.2015, i cili aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.3794/2015 të datës 09.05.2019, me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë ka detyruar të paditurën që paditësit të ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, dhe këtë vendim e ka marrë konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike del të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës se vendosjes të cilat i pranon si të rregullta edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n). Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike ku sa i përket bazës së kërkesëpadsisë e lidhur me shkaktarin e aksidenti-lëndime e paditësit në punë është vërtetuar përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.2019/12 i datës 06.08.2015 i cili është vërtetuar sa i përket bazës me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.3794/15 I dt.05.09.2019 ku me këtë aktgjykim është ndryshuar vetëm lartësia e demit jomaterial, ndërsa është kthyer ne rigjykim pjese e demit material për shpenzime te rehabilitimit shëndetësor, shpenzimet e shërimit dhe shpenzimet e procedurës, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.408/2020 dt.06.07.2020 është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përveç pjesës që ka të bej me demin jo material i cili është ndryshuar vetëm për lartësinë e këtij lloji të demit. Sa i përket shkaktari të lëndime të paditësit ne punë tek e paditura përmes aktgjykimeve të lartcekura është vërtetuar se me dt.07.07.2012 paditësi është lënduar në vendin e punës gjatë rregullimit të siguresave TL dhe se e paditura nuk e ka trajnuar paditësin nga lemia e mbrojtjes në punë dhe se paditësi është lënduar me fajin e të paditurës, pra në rastin konkret kemi të bëjmë objektive të paditurës në kuptim të nenit 173 të LMD-së dhe se në këtë rast barra e provës mbi mbi të paditurën për të provuar se paditësi është lënduar për arsye që janë jashtë të paditurës.

Sa i përket lëndimeve të paditësit në aksidentin e ndodhur në punë e njëjta është vërtetuar po ashtu me aktgjykimet e lartcekura ku nder te tjera me këto aktgjykimi është konstatuar se paditësi ka pësuar zvogëlim të aftësisë në punë në shkallë 100%. Po ashtu nga aktgjykimet e lartcekura përveç tjerash është vendosur edhe për pagat e pa paguara për përudhen korrik 2012 deri ne muajin maj 2014, ndërsa nuk është vendosur për rentën në të ardhmen.

Sa i përket lartësisë së kërkesë-padsisë në bazë të ekspertizës dhe plotësimit të saj të ekspertit aktuar Aziz Berisha nga Prishtina i cili kanë dhënë ekspertiza në këtë procedurë në formë të shkruar dhe në bazë të deklaramit të tyre në shqyrtimin gjyqësor ku sa i përket kriterit të demit i referohet fitimit të humbur ka konstatuar se për periudhën prej datës së aksidentit 08.05.2016

e gjerë me datën 31.03.2021, fitimi i humbur është në shumën e përgjithshme prej 15,303€, ndërsa për kamat e arritur për këtë përudh shumen prej 2,843€, ndërsa sa i përket rentës mujore për të ardhmen dhe atë duke filluar nga data 01.04.2021 e deri sa ekzistojnë kushtet ligjore i është njohur 260€ shuma mujore dhe atë në fund të secilit muaj e më së voni deri me datën pesë të muajit vijues për muajin paraprak si pasojë e aksidentit të pësuar pasi që e njëjti ka zvogëlim të aktivitetit punues 100%. Gjykata e shkalles së parë me te drejt ja ka falur besimin kësaj ekspertize pasi që e njëjta është punuar në mënyrë profesionale profesionale. Po ashtu gjykata e shkalles së parë me drejt e ka vendosur si alternativ rentën për të ardhmen kur ka vendosur se lartësia e rentës mund të ndryshohet nëse paditësit i ndërpritet marrja e pensionit të veteranit.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale sepse sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadiës rreth kompensimit të dëmit material për rentën dhe fitimin e humbur për arsyes se me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: "Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ", Ndërsa me nenin 140 të LMD-së përcaktohet se: "Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia".

Me nenin 172 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në paragrafin 1 dhe 2 përcaktohet: "1. Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. 2. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër ", ndërsa për fitimin e humbur për periudhën e kaluar vendimi është marr ne përputhje me nenin 173 të LMD-së me të cilin përcaktohet: "I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e demit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.

Në raport me lartësinë e rentës me të drejtë i është falur besimi ekspertizës përkatëse pasi e njëjta është punuar në mënyrë të drejtë dhe profesionale dhe janë dhënë arsye të duhura gjithmonë duke u bazuar në të dhëna shkencore dhe njohuri profesionale të ekspertit dhe standardit vendor.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelle, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara dhe nuk gjeti arsye për një vendosje ndryshe nga ajo sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit lidhur me afatshmërinë e padisë për kjo Gjykate, vlerësoi se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar, për shkak se, në bazë të nenit Neni 357 i LMD paragrafi 1 dhe 2 përcaktojnë se: "1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe e cila ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik si dhe kohen për të cilën është kërkuar detyrimi për kompensimin në emër të renta dhe atë nga dt.08.05.2016, si dhe kohen e paraqitjes së padis me dt.24.04.2017, rrjedh se padia e paditësit është e lejuar dhe e ushtruar brenda afatit kohor.

Gjykata e vlerësoi edhe parashtresën e të paditurës me të cilin është kërkuar të ndërpritet procedura për shkak të vdekjes së paditësit e të cilës parashtresa i është bashkangjitur edhe certifikata e vdekjes së paditësit mirëpo kjo gjykata konsideron se në këtë rast nuk bazë për ndërprerje dhe atë duke u bazuar ne nenin 277, të LPK-së, dhe nenin 18, të Ligjit Nr. 04/L-

118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 277 i ligjit bazik, përcaktohet se: “ Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale; b) kur përfaqësuesi ligjor i palës vdesë ose shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, e pala nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim; c) kur pala që është person juridik pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent jep vendim të formës së prerë për ndalimin e punës tij; d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues; e) kur për shkak të luftës ose për shkaqe të tjera pushon puna në gjykatë; f) kur ndërprerja e gjykimin parashihet me ndonjë ligj tjetër ”.

Nga interpretimi i nenit 277 të LPK-së, rezulton qartë se ndërprerja e procesit gjyqësorë mund të behet kryesisht vetëm në gjykatën e shkallës së parë, që nga momenti kur paraqitet padia në gjykatë e deri në përfundimin e procesit gjyqësorë (shqyrtimit kryesorë - në shkallë të parë) dhe përjashtimisht në gjykatën e shkallës së dytë dhe atë: nëse gjykata e shkallës së dytë vendosë për ankesën në seancë të trupit gjykues ose në bazë të shqyrtimit të çështjes në seanca gjyqësore, siç përcaktohet me nenin 190 të LPK-së, dhe në këto raste gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në kuptim të nenit 191, 192 dhe 193 të LPK-së. Në këtë rast gjykata e shkallës së dytë nuk ka vendosur për ankesën në bazë të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore siç përcaktohen me nenin 190 të LPK-së, e nga kjo rezulton se neni 277 i LPK-së, nuk ka mundur të zbatohet në këtë rast. Përveç të cekurave kjo gjykatë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi, por ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, andaj edhe pretendimet e palës së paditur në raport me shpenzimet i refuzoi si të pabazuara si dhe të pa mbështetura në prova.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi I pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.7046/21, me datë 11.06.2024

Kryetar i kolegjit  
Naim Mehollli, d.v